

VENDIM

Nr. 16, Datë 28 / 06 /2018

PËR

MIRATIMIN E RREGULLOREVE DHE KRITEREVE TË KONKURISIT TË PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në zbatim të, Nenit 38-Funksionet e Senatit Akademik, *e vijim* - të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", shkresës Nr. 49 prot., datë 11.05.2018, të Fakultetit të Arteve të Bukura, Senati Akademik i UART, pasi diskutoi mbi "Rregulloret dhe Kriteret e konkursit të pranimit për vitin akademik 2019-2020, të Fakultetit të Arteve të Bukura, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë "Bachelor" dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve" relatuar nga Dekani i FAB, Prof. Asoc. Ardian Isufi,

VENDOSI

1. Miratimin e "Rregulloreve dhe Kriterëve të konkursit të pranimit për vitin akademik 2019-2020, të Fakultetit të Arteve të Bukura, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë "Bachelor" dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve".
Bashkëlidhur, Rregullorja dhe kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të parë me kohë të plotë "Bachelor" si dhe Rregullorja dhe Kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve", të Fakultetit të Arteve të Bukura.
2. Ky Vendim, të publikohet në faqen zyrtare të UART.
3. Rregulloret dhe kriteret e konkursit të dërgohen zyrtarisht në MASR si dhe të përditësohen në portalin UALBANIA.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Milto KUTALI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Najada HAMZAJ



Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Nansy GJERAZI

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Rafael HOXHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA
DEKANI

Nr. 49 prot.

Tiranë, më 11.05.2018

Lënda: përcjellje rregullore dhe kriteresh për konkurset Bachelor 2019-2020

Drejtuar :: ZV/ Rektorit të UART, Prof. Dr. Erald Bakalli,

Bashkëngjitur do të gjeni Rregulloren dhe Kriteret e Konkurseve të Ciklit I-Bachelor për 7 programet në Fakultetin e Arteve të Bukura për vitin akademik 2019-2020.

Prof. Asc. Ardian ISUFI

DEKAN
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA



Tiranë, më ____/____/2018

RREGULLORE

**PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT
NË 7 PROGRAMET E CIKLIT TË PARË
"BACHELOR"
NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA,
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE
PËR VITIN AKADEMIK 2019 – 2020**

MIRATUAR ME VENDIM NR _____, DATË _____

TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE



Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 74, Pranimi në ciklin e parë të studimeve, si dhe mbështetur në Rregulloren e UART të ciklit të parë të studimeve "Bachelor", konkurset e pranimit në Fakultetin e Arteve të Bukura për vitin akademik 2018-2019 do të zhvillohen si më poshtë:

Neni 1

Pranimi i kandidatëve

- 1.1. Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Arteve të Bukura në Universitetin e Arteve, bëhet mbi rezultatin e konkurseve që zhvillohen pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit, sipas kësaj Rregulloreje, si dhe kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve dhe pikëve totale të Maturës Shtetërore.
- 1.2. Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta Për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3. Përzgjedhja e konkurrentëve është e ndërvarur nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për të gjitha kategoritë.
- 1.4. Pikët maksimale të vlerësimit si dhe ndarjen e tyre në përqindje, kufiri minimal i pikëve të pranimit për çdo konkurrent do të zbatohet sipas Vendimit të Senatit Akademik.

Neni 2

Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 2.1. Dekani i Fakultetit, mbështetur në propozimet e Përgjegjësve të Njësive Bazë, merr masa dhe organizon ngritjen e Komisionit të Pranimit.
- 2.2. Komisionet e pranimit ngrihen për secilin program studimi.
- 2.3. Përbërja e anëtarëve të Komisionit të Pranimit shpallet në ditën e fundit të konkursit të punës praktike në atelier.
- 2.4. Në përbërjen të Komisionit të Pranimit aktivizohen:
 - I. Titullarë të fushës përkatëse,
 - II. Pedagogë me kohë të plotë të Departamenteve përkatëse,
 - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës, për ato programe studimi që nuk mbulohen nga pikat I dhe II të këtij neni.
- 2.5. Në përbërje të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë konflikt interesi me konkursin e pranimit.
- 2.6. Në mjediset ku zhvillohen konkurset nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga Titullari i Fakultetit të Arteve të Bukura.
- 2.7. Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të posatshëm, ngre grupin përkatës, që monitoron cilësinë e zhvillimit të gjithë procedurave të konkurimit në Fakultetin e Arteve të Bukura, si dhe nga përfaqësuesit e MAS.



Neni 3

Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurrimit.

- 3.1 Kanë të drejtë të regjistrohen në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
- 3.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Arteve të Bukura.
- 3.3 Konkurset për shtatë programet e studimit në Fakultetin e Arteve të Bukura do të zhvillohet në mjediset e Fakultetit, në zbatim të kësaj rregulloreje, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.
- 3.4 Lejohen të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurim, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi si më poshtë:
 - I. *Kartë Identiteti / Pasaportë.*
 - II. *Vërtetimin e regjistrimit të marrë nga sekretaria e fakultetit të Arteve të Bukura.*
 - III. *Mandatpagesën për pjesëmarrje në konkursin e pranimit, e depozituar në llogarinë e Universitetit të Arteve.*
(Kandidati që s'paraqet këto dokumente, nuk lejohet të marrë pjesë në konkurs).
- 3.5 Në varësi të specifikave komisioni do të punojë paradite dhe pasdite me paraqitjet individuale të kandidatëve, duke i bërë më parë të njohura oraret përkatëse. Njoftimet për oraret shpallen pranë Fakultetit të Arteve të Bukura.
- 3.6 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe mjediset e zhvillimit të tyre, do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve, pranë Fakultetit të Arteve të Bukura. Ky kalendar shpallet në Fakultet dhe Ëeb-in e Universitetit të Arteve, një javë përpara fillimit të konkursit.
- 3.7 Në momentin e regjistrimit, në formularin që plotëson pranë sekretarisë, konkurenti përzgjedh programin e studimit, sipas dëshirës (*Pikturë Kavaleti, Pikturë Monumentale, Pikturë Grafikë, Pikturë Tekstil, Pikturë Multimedia, Skulpturë dhe Skulpturë Qeramikë*). Ai ka mundësi përzgjedhjeje vetëm për një program studimi në të cilin konkuron në fazën e parë, por mund të rikonkurrojë në një program tjetër studimin në fazën e dytë nëse nuk shpallet fitues në të parin.
- 3.8 Ditën e parë të konkursit, pasi të jenë sistemuar në atelierët përkatës, konkurentëve u komunikohen të gjitha rregullat e konkurrimit.
- 3.9 Sekretaria mësimore, vulos secilën fletë vizatimi ose telajo pikturë të konkurentëve pjesëmarrës, pasi konkurentët kanë filluar punë. Në përfundim të ditës së dytë çdo konkurent shkruan në punën e tij/e saj, në anën e djathtë, poshtë, emrin dhe mbiemrin. Sekretaria mësimore, në prani të konkurentit, mbi emrin e shkruar, vendos një zarf dhe e vulos atë.
- 3.10 Sekretaria mësimore i dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të gjitha materialet për konkurs, si dhe listat e konkurentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 3.11 Bazuar në kriteret për secilin program studimi, komisioni krijon hapësirën kohore të nevojshme për prezantimin individual të kandidatëve gjatë konkurrimit.



Neni 4

Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- 4.1 Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhet nga Komisioni i Pranimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohen nga Titullari i Fakultetit.
- 4.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre) anëtarë.
- 4.3 Gjatë paraqitjes individuale të kandidatëve, anëtarët e jurisë mbajnë shënimet përkatëse. Po ashtu, çdo anëtar i jurisë, ka të drejtë t'i drejtojë kandidatin që konkurren pyetje konkrete, të cilat i duken të arsyeshme, për një njohje sa më të mirë të tij.
- 4.4 Mbas paraqitjes së kandidatit të fundit, në mbarim të gjithë seancave që parashikohen në kriteret e konkurrimit, Komisioni i Pranimit, nën drejtimin e Kryetarit, mblidhet për të vlerësuar një për një paraqitjen e secilit kandidat. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 4.5 Pikët e mundshme në dispozicion të Komisionit të Pranimit, të miratuara nga Vendimi i Senatit Akademik, shpërndahen në mënyrë të barabartë tek të gjithë anëtarët e komisionit. Secili anëtar vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.
- 4.6 Komisioni i Pranimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista rendore, me pikët e konkurrentëve me rend zbritës, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- 4.7 Lista e nënshkruar e pjesëmarrësve në konkursin e pranimit, sipas formatit elektronik të dërguar nga AKP, si dhe shënimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit për secilin konkurrent, me të gjitha dosjet me materialet e mësipërme, i dorëzohen me procesverbal Dekanit të Fakultetit.

Neni 5

Shpallja e fituesve

- 5.1 Renditjen e listës së fituesve, sipas pikëve të marra nga Komisioni i Pranimit të konkursit, duke i bashkuar edhe pikët e maturës shtetërore, e bën sekretaria mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura.
- 5.2 Në rastin kur disa konkures kanë fituar të njëjtin shumë pikësh, ata nënrenditen midis tyre sipas rendit zbritës të pikëve të fituara në punën praktike të realizuar në atelie.
- 5.3 Lista përfundimtare me pikët me rend zbritës, duke vendosur vijën e kuqe, mbështetur në kuotat e miratuara nga MAS, e firmosur nga Dekani i Fakultetit, i përcillet Rektoratit.



Neni 6

Regjistrimi për të fituar statusin e studentit

- 6.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të rregjistrohen për të fituar statusin e studentit.
- 6.2 Kandidatët që rregjistrohen si studentë në Universitetin e Arteve, duhet të paraqesin **dokumente origjinale**. Ato duhet të jenë në vartësi të Udhëzimeve të MAS.
- 6.3 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet:
 - I. Numri i rregjistrimit,
 - II. Emri i kandidatit
 - III. Data dhe ora e rregjistrimit.Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 6.4 Në rregjistër çdo kandidat fitues duhet të nënshkruajë.
- 6.5 Kandidatit që rregjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale, por jo pagesa e rregjistrimit.
- 6.6 Rregjistrimet e kandidatëve fitues, për të gjitha kuotat, kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Arteve të Bukura, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Neni 7

Rregulla për kandidatët

Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:

- 7.1 Kandidatët duhet të paraqiten në Fakultet ditën e parë të fillimit të konkursit, në orën e përcaktuar në kalendarin e zhvillimit të konkurseve, e shpallur në Fakultetin e Arteve të Bukura.
- 7.2 Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Pranimi në bazë të orarit që do të përcaktojë Komisioni.
- 7.3 Mosparaqitja në këtë orar çon në skualifikimin e tij nga konkursi.
- 7.4 Konkursi është kolektiv dhe individual.
- 7.5 Kandidati duhet të plotësojë para Komisionit kërkesat që rrjedhin nga kriteret për çdo Program Studimi.
- 7.6 Komisioni krijon atmosferën e nevojshme që kandidati të shprehë sa më mirë aftësitë e tij.
- 7.7 Kandidati do të largohet nga konkurrimi vetëm kur komisioni t'ia kërkojë këtë gjë, pasi ka ezauruar procesin e pyetjeve.

DEKANI

Prof. Asoc. Ardian Isufi



Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ 2018

Drejtuar: Dekanit të FAB, Prof. Asc, Ardian Isufi

Lënda:

**KRITERET TEKNIKE SI DHE RUBRIKAT E KONKURISIT TË PRANIMIT NË
CIKLIN I - BACHELOR
FAKULTETI I ARTEVE TE BUKURA, PROGRAMI I STUDIMIT PIKTURË
MONUMENTALE
VITI AKADEMIK 2019-2020**

Konkursi për seleksionim dhe përzgjedhjen e kandidatëve të rinj për Programin e studimit Pikturë Monumentale do të zhvillohet sipas kriterëve teknike të përcaktuara si më poshtë:

Konkursi do të mbështetet në tre rubrika kryesore për të arritur nivelin më të mirë të mundshëm të testimit të një kandidati brenda kohës së caktuar:

- 1. Punë Praktike në Atelie (pikturw, vizatim)**
- 2. Testim teorik**
- 3. Prezantim i dosjes personale**

1. Puna Praktike në Atelie do të zhvillohet si më poshtë:

Kohëzgjatja : 2 ditë nga 5 orë

Tema e veprës: Studim dhe interpretim nga natyra duke ju referuar figurës së njeriut (model nga natyra)

Dimensioni i veprës: 70 x 90 cm

Teknika e perdorur: Vizatim ose Pikturë



Disa sqarime të mëtejshme:

Në të gjitha atelietë e shkollës ku do të zhvillohet testimi praktik i kandidatëve për studentë do të ketë modele të vendosur (figurë njeriu).

Studentët do të prezantohen me modelet dhe më pas ata do të vendosin:

- a. Cilin model zgjedhin.
- b. Mënyrën se si kompozojnë.
- c. Teknikën me të cilin realizojnë veprën.

Modeli i propozuar (figurë njeriu) para kandidatëve, shërben si shkak që ata, në mënyrë të ndërgjegjshme të ekspozojnë më qartë një qëndrim individual të shprehjes artistike. Duke mos kushtëzuar prerjen e figurës sipas nje kompozimi standart, si dhe teknikën me të cilën do të realizohet vepra, studenti t i jepet mundësia të interpretojë nga pikëpamja kompozicionale, si edhe në drejtim të hulumtimit psikologjik, të zgjedhë mjetin dhe format e shprehjes nëpërmjet një raporti ndjesor më personal me figurën e propozuar.

Baza Materiale

Kandidatët për Studentë duhet të vijnë të përgatitur me këto materiale përkatëse:

Letër Vizatimi 70x90, (të bardhë)

Telajo Pikturë 70x90, si dhe të gjitha mjetet e tjera plotësuese për të realizuar një vepër në vizatim apo në telajo(pikturë).

2. Testimi Teorik, i cili në vetevete përmban tre faza të përshkruara si më poshtë:

Kohëzgjatja: 2 ditë + (në varësi të nr. të konkurentëve)

Faza e parë është testimi teorik i kandidatit për student në Lëndën Histori Arti, nëpërmjet përgjigjes direkte mbi tezën e zgjedhur. Teza është e fshehte.

Literatura së ciles do t'i referohet cdo kandidat per tu përgatitur:

- Të gjithë tekstet teorike apo materialet me të cilat kanë studiuar nxenesit në shkollat e mesme artistike apo të përgjithshme.
- Historia e Artit (E.H. Gombrich)
- Aventurë e Artit në shek.XX dhe materiale të tjera alternative.

Faza e Dytë është intervista e kandidatit për student me anëtarët e Komisionit.



Qëllimi është testimi i nivelit të përgjithshëm kulturor, ndjeshmëritë artistike, marrëdhënien e tij me një proces artistik që ai kryen, kërkesat e tij, si dhe ato cka ky fakultet kërkon prej.

Faza e Tretë është shqyrtimi i **Dosjes Personale** të kandidatit për student, në të cilën ai prezanton një grup punësh të realizuara kryesisht gjatë dy viteve të fundit. Këto punë mund dhe duhet të plotësojnë imazhin e punës praktike që ai kryen në atelier në dy ditët e para të konkursit.

Dosja profesionale personale do të duhet të përmbajë vizatime e skica të ndryshme, realizime me laps karbon etj., si edhe realizime në vaj, tempera, akuarel etj. Numri i përgjithshëm i punimeve që duhet të përmbajë dosja të jetë jo më pak se 20.

Shënim:

Kandidati për student është përgjegjës për autorësinë e materialit që prezanton në dosjen e tij personale. N.q.s nga Komisioni verifikohet material i manipuluar, pra jo produkt i kandidatit, ndaj tij do të merret masa e largimit nga procesi i konkursit për këtë vit akademik.

Përgjegjësi i Departamentit të Pikturës

Prof. Asc. Edmond Gjokopulli



Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ 2018

Drejtuar : Dekanit te FAB, Prof.Asc, Ardian Isufi

Lenda:

**KRITERET TEKNIKE SI DHE RUBRIKAT E KONKURSIT TË PRANIMIT NË
CIKLIN I-BACHELOR-FAKULTETIN E ARTEVE TE BUKURA
PROGRAMI I STUDIMIT PIKTURE MULTIMEDIA
VITI AKADEMIK 2019-2020**

Konkursi për seleksionim dhe përzgjedhjen e kandidatëve të rinj do të zhvillohet sipas kriterëve teknike të përcaktuara si më poshtë:

Konkursi do të mbështetet në tre rubrika kryesore për të arritur nivelin më të mirë të mundshëm të testimit të një kandidati brenda kohës së caktuar:

Rubrikat:

- 1. Punë Praktike në Atelie (pikturë, vizatim)**
 - 2. Testim teorik**
 - 3. Prezantim i dosjes personale (orientimi multimedia)**
- 1. Punë Praktike në Atelie** do të zhvillohet si më poshtë:

Kohëzgjatja : 2 ditë nga 5 orë

Tema e veprës: Studim dhe interpretim nga natyra duke ju referuar figurës së njeriut (model nga natyra)

Dimensioni i veprës: Jo më e vogël se 70 x 90 cm

Teknika e përdorur: Vizatim ose Pikturë.



Disa sqarime të mëtejshme :

Në të gjitha atelietë e shkollës ku do të zhvillohet testimi praktik i kandidatëve për studentë do të ketë modele të vendosur (figurë njeriu).

Studentët do të prezantohen me modelet dhe më pas ata do të vendosin:

- a. Cilin model zgjedhin.
- b. Mënyren se si kompozojnë.
- c. Teknikën me të cilin realizojnë veprën.

Modeli i propozuar (figurë njeriu) para kandidateve, shërben si shkak që ata, në mënyrë të ndërgjegjshme të ekspozojnë më qartë një qëndrim individual të shprehjes. Duke mos kushtezuar prerjen e Figurës sipas nje kompozimi Standart, si dhe teknikën me të cilën do të realizohet vepra, studentit vihet në pozicion krijues, ku l jepet mundësia të interpretojë si nga pikepamja kompozicionale po ashtu edhe ne drejtim të hulumtimit psikologjik, të zgjedhë mjetin dhe format e shprehjes nëpërmjet një raportit ndjesor më personal me figurën e propozuar.

Baza Materiale

Kandidatët për Studentë duhet të vijnë te përgatitur me këto materiale përkatëse:

Letër Vizatimi formati 70x90, (të bardhë)

Telajo Pikturë formati 70x90, si dhe të gjitha mjetet e tjera plotësuese për të realizuar një vepër në vizatim apo në telajo(pikturë).

2. Testimi Teorik i cili ne vetevete permban tre faza të përshkruara si më poshte

Kohezgjatja: 2 dite + (në varësi të nr. të konkurentëve)

Fazat:

Faza e parë është Testimi i Kandidatit për Student në Lenden Histori Arti. Ky testim do të kryhet nëpërmjet përgjigjes direkte mbi Tezen e Zgjedhur. Teza është e fshehte.

Literaturë së ciles do t'i referohet cdo kandidat për tu përgatitur:

- Të gjithë tekstet teorike apo materialet me të cilat kanë studiuar nxenesit në shkollat e mesme artistike apo te pergjithshme
- Historia e Artit (E.H. Gombrich)



- Aventurë e Artit në shek.XX dhe materiale të tjera alternative.

Faza e Dytë është Interviste e Kandidatit për Student me Anëtarët e Komisionit.

Qëllimi është: Për të testuar nivelin e përgjithshëm kulturor, ndjeshmëritë artistike, marrëdhënien e tij me një proces artistik që ai kryen, e lidhur kjo ngushtë me formacionin e fakultetit, kërkesat tij si dhe ato cka ky fakultet kërkon prej studenteve dhe i ofron atyre njekoheisht.

Faza e Tretë është shqyrtimi i Dosjes Personale të Kandidatit për Student, në të cilën ai prezanton praktikisht një grup punesh të kryera prej tij kryesisht gjate dy viteve të fundit, dhe që ai mendon se bëjnë prezantimin më të mirë artistik të tij. Këto punë mund dhe duhet të plotësojnë imazhin e punës praktike që ai kryen në atelie në dy ditët e para të konkursit.

Dosje personale do te duhet te mbaje:

Vizatime e skica të ndryshme, realizime me laps karbon, fotografi, video, material vizive per multimediale. etj.

Realizime në vaj, tempera, akuarel etj.

Numri i përgjithshëm i punimeve që duhet të përmbajë dosja të jetë jo më pak se 20.

Shënim: Kandidati për student është përgjegjës për autorësinë e materialit që prezanton në dosjen e tij personale. N.q.s nga Komisioni verifikohet material i manipuluar, pra jo produkt i kandidatit, ndaj tij do të merret masa e largimit nga procesi i konkursit për këtë vit akademik.

Pergjegjesi i Dep, te Arteve te Aplikuar

Prof. Asc. Albes Fusha



Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ 2018

Drejtuar : Dekanit te FAB, Prof.Asc, Ardian Isufi

Lenda:

KRITERET TEKNIKE SI DHE RUBRIKAT E KONKURISIT TË PRANIMIT NË

CIKLIN I-BACHELOR-FAKULTETIN E ARTEVE TE BUKURA

PROGRAMI I STUDIMIT PIKTURE GRAFIKE

VITI AKADEMIK 2019-2020

Konkursi për seleksionim dhe përzgjedhjen e kandidatëve të rinj do të zhvillohet sipas kriterëve teknike të përcaktuara si më poshtë:

Konkursi do të mbështetet në tre rubrika kryesore për të arritur nivelin më të mirë të mundshëm të testimit të një kandidati brenda kohës së caktuar:

Rubrikat:

- 1. Punë Praktike në Atelie (pikturë, vizatim)**
- 2. Testim teorik**
- 3. Prezantim i dosjes personale (orientimi grafike)**

1. Punë Praktike në Atelie do të zhvillohet si më poshtë:

Kohëzgjatja : 2 ditë nga 5 orë

Tema e veprës: Studim dhe interpretim nga natyra duke ju referuar figurës së njeriut (model nga natyra)

Dimensioni i veprës: formati 70 x 90 cm

Teknika e përdorur: Vizatim ose Pikturë.



Disa sqarime të mëtejshme të kriterëve të mësipërme.

Studimi nga Natyra do të propozohet dhe organizohet si më poshtë:

Në të gjitha atelietë e shkollës ku do të zhvillohet testimi praktik i kandidatëve për studentë do të ketë modele të vendosur (figurë njeriu).

Studentët do të prezantohen me modelet dhe më pas ata do të vendosin:

- a. Cilin model zgjedhin.
- b. Mënyren se si kompozojnë.
- c. Teknikën me të cilin realizojnë veprën.

Modeli i propozuar (figurë njeriu) para kandidateve, shërben si shkak që ata, në mënyrë të ndërgjegjshme të ekspozojnë më qartë një qëndrim individual të shprehjes. Duke mos kushtezuar prerjen e Figurës sipas nje kompozimi Standart, si dhe teknikën me të cilën do të realizohet vepra, studenti vihet në pozicion krijues, ku I jepet mundësia të interpretojë si nga pikepamja kompozicionale po ashtu edhe ne drejtim të hulumtimit psikologjik, të zgjedhë mjetin dhe format e shprehjes nëpërmjet një raporti ndjesor më personal me figurën e propozuar.

Baza Materiale

Kandidatët për Studentë duhet të vijnë te përgatitur me këto materiale përkatëse:

Letër Vizatimi formati 70x90, (të bardhë)

Telajo Pikturë formati 70x90, si dhe të gjitha mjetet e tjera plotësuese për të realizuar një vepër në vizatim apo në telajo(pikturë).

2. Testimi Teorik i cili ne vetevete permban tre faza të përshkruara si më poshte

Kohezgjatja: 2 dite + (në varësi të nr. të konkurentëve)

Fazat:

Faza e parë është Testimi i Kandidatit per Student ne Lenden Histori Arti. Ky testim do te kryhet nepermjet pergjigjes direkte mbi Tezen e Zgjedhur. Teza eshte e fshehte.



Literaturë së ciles do t'i referohet cdo kandidat për t'u përgatitur:

- Të gjithë tekstet teorike apo materialet me të cilat kanë studiuar nxenesit në shkollat e mesme artistike apo te përgjithshme
- Historia e Artit (E.H. Gombrich)
- Aventurë e Artit në shek.XX dhe materiale të tjera alternative.

Faza e Dytë është Interviste e Kandidatit për Student me Anëtarët e Komisionit.

Qëllimi është: Për të testuar nivelin e përgjithshëm kulturor, ndjeshmëritë artistike, marrëdhënien e tij me një proces artistik që ai kryen, e lidhur kjo ngushte me formacionin e fakultetit, kerkesat tij si dhe ato cka ky fakultet kërkon prej studenteve dhe i ofron atyre njekohesisht.

Faza e Tretë është shqyrtimi i Dosjes Personale të Kandidatit për Student, në të cilën ai prezanton praktikisht një grup punesh të kryera prej tij kryesisht gjate dy viteve të fundit, dhe që ai mendon se bëjnë prezantimin më të mirë artistik të tij. Këto punë mund dhe duhet të plotësojnë imazhin e punës praktike që ai kryen në atelie në dy ditët e para të konkursit.

Dosje profesionale personale duhet te permbaje:

Vizatime e skica të ndryshme, realizime me laps karbon, gravure ne teknika te ndryshme, fotografi, realizime ne dizajnin grafik, realizime ne zhanrin e fumetit dhe animacionit. etj.
Realizime në vaj, tempera, akuarel etj.

Numri i përgjithshëm i punimeve që duhet të përmbajë dosja të jetë jo më pak se 20.

Shënim: Kandidati për student është përgjegjës për autorësinë e materialit që prezanton në dosjen e tij personale. N.q.s nga Komisioni verifikohet material i manipuluar, pra jo produkt i kandidatit, ndaj tij do të merret masa e largimit nga procesi i konkursit për këtë vit akademik.

Përgjegjesi i Dep, te Arteve te Aplikuara

Prof. Asc. Albes Fusha



Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ 2018

Drejtuar : Dekanit te FAB, Prof.Asc, Ardian Isufi

Lenda:

KRITERET TEKNIKE SI DHE RUBRIKAT E KONKURISIT TË PRANIMIT NË

CIKLIN I-BACHELOR-FAKULTETIN E ARTEVE TE BUKURA

PROGRAMI I STUDIMIT TEKSTIL DHE MODE

VITI AKADEMIK 2019-2020

Konkursi për seleksionim dhe përzgjedhjen e kandidatëve të rinj do të zhvillohet sipas kriterëve teknike të përcaktuara si më poshtë:

Konkursi do të mbështetet në tre rubrika kryesore për të arritur nivelin më të mirë të mundshëm të testimit të një kandidati brenda kohës së caktuar:

Rubrikat:

- 1. Punë Praktike në Atelie (pikturë, vizatim)**
- 2. Testim teorik**
- 3. Prezantim i dosjes personale (orientimi tekstil dhe mode)**

1. Punë Praktike në Atelie do të zhvillohet si më poshtë:

Kohëzgjatja : 2 ditë nga 5 orë

Tema e veprës: Studim dhe interpretim nga natyra duke ju referuar figurës së njeriut (model nga natyra)

Dimensioni i veprës: formati 70 x 90 cm

Teknika e përdorur: Vizatim ose Pikturë.



Disa sqarime të mëtejshme të kriterëve të mësipërme.

Studimi nga Natyra do të propozohet dhe organizohet si më poshtë:

Në të gjitha atelietë e shkollës ku do të zhvillohet testimi praktik i kandidatëve për studentë do të ketë modele të vendosur (figurë njeriu).

Studentët do të prezantohen me modelet dhe më pas ata do të vendosin:

- a. Cilin model zgjedhin.
- b. Mënyren se si kompozojnë.
- c. Teknikën me të cilin realizojnë veprën.

Modeli i propozuar (figurë njeriu) para kandidateve, shërben si shkak që ata, në mënyrë të ndërgjegjshme të ekspozojnë më qartë një qëndrim individual të shprehjes. Duke mos kushtezuar prerjen e Figurës sipas nje kompozimi Standart, si dhe teknikën me të cilën do të realizohet vepra, studentit vihet në pozicion krijues, ku i jepet mundësia të interpretojë si nga pikepamja kompozicionale po ashtu edhe në drejtim të hulumtimit psikologjik, të zgjedhë mjetin dhe format e shprehjes nëpërmjet një raporti ndjesor më personal me figurën e propozuar.

Baza Materiale

Kandidatët për Studentë duhet të vijnë të përgatitur me këto materiale përkatëse:

Letër Vizatimi formati 70x90, (të bardhë)

Telajo Pikturë formati 70x90, si dhe të gjitha mjetet e tjera plotësuese për të realizuar një vepër në vizatim apo në telajo(pikturë).

2. Testimi Teorik i cili në vetevetë përmban tre faza të përshkruara si më poshtë

Kohezgjatja: 2 dite + (në varësi të nr. të konkurentëve)

Fazat:

Faza e parë është Testimi i Kandidatit për Student në Lendën Histori Arti. Ky testim do të kryhet nëpërmjet përgjigjes direkte mbi Tezen e Zgjedhur. Teza është e fshehtë.

Literaturë së ciles do t'i referohet çdo kandidat për tu përgatitur:



- Të gjithë tekstet teorike apo materialet me të cilat kanë studiuar nxenesit në shkollat e mesme artistike apo te pergjithshme

- Historia e Artit (E.H. Gombrich)

- Aventurë e Artit në shek.XX dhe materiale të tjera alternative.

Faza e Dytë është Interviste e Kandidatit për Student me Anëtarët e Komisionit.

Qëllimi është: Për të testuar nivelin e përgjithshëm kulturor, ndjeshmëritë artistike, marrëdhënien e tij me një proces artistik që ai kryen, e lidhur kjo ngushte me formacionin e fakultetit, kërkesat tij si dhe ato cka ky fakultet kërkon prej studenteve dhe i ofron atyre njekohesisht.

Faza e Tretë është shqyrtimi i Dosjes Personale të Kandidatit për Student, në të cilën ai prezanton praktikisht një grup punesh të kryera prej tij kryesisht gjate dy viteve të fundit, dhe që ai mendon se bëjnë prezantimin më të mirë artistik të tij. Këto punë mund dhe duhet të plotësojnë imazhin e punës praktike që ai kryen në atelie në dy ditët e para të konkursit.

Dosje profesionale personale duhet të përmbaje:

Vizatime e skica të ndryshme, realizime me laps karbon, realizime në fashion dhe mode, realizime me tendenca të artit dekorativ. foto fashion.etj.
Realizime në vaj, tempera, akuarel etj.

Numri i përgjithshëm i punimeve që duhet të përmbajë dosja të jetë jo më pak se 20.

Shënim: Kandidati për student është përgjegjës për autorësinë e materialit që prezanton në dosjen e tij personale. N.q.s nga Komisioni verifikohet material i manipuluar, pra jo produkt i kandidatit, ndaj tij do të merret masa e largimit nga procesi i konkursit për këtë vit akademik.

Pergjegjesi i Dep, te Arteve te Aplikuara

Prof. Asc. Albes Fusha



Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ 2018

Drejtuar: Dekanit të FAB, Prof. Asc, Ardian Isufi

Lënda:

**KRITERET TEKNIKE SI DHE RUBRIKAT E KONKURSIT TË PRANIMIT NË
CIKLIN I - BACHELOR
FAKULTETI I ARTEVE TE BUKURA, PROGRAMI I STUDIMIT PIKTURË KAVALETI
VITI AKADEMIK 2019-2020**

Konkursi për seleksionim dhe përzgjedhjen e kandidatëve të rinj për Programin e studimit Pikturë Kavaleti do të zhvillohet sipas kriterëve teknike të përcaktuara si më poshtë:

Konkursi do të mbështetet në tre rubrika kryesore për të arritur nivelin më të mirë të mundshëm të testimit të një kandidati brenda kohës së caktuar:

- 1. Punë Praktike në Atelie (pikturë, vizatim)**
- 2. Testim teorik**
- 3. Prezantim i dosjes personale**

1. Puna Praktike në Atelie do të zhvillohet si më poshtë:

Kohëzgjatja : 2 ditë nga 5 orë

Tema e veprës: Studim dhe interpretim nga natyra duke ju referuar figurës së njeriut (model nga natyra)

Dimensioni i veprës: 70 x 90 cm

Teknika e përdorur: Vizatim ose Pikturë



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 247 597, www.uart.edu.al
Disa sqarime të mëtejshme:

Në të gjitha atelietë e shkollës ku do të zhvillohet testimi praktik i kandidatëve për studentë do të ketë modele të vendosur (figurë njeriu).

Studentët do të prezantohen me modelet dhe më pas ata do të vendosin:

- a. Cilin model zgjedhin.
- b. Mënyrën se si kompozojnë.
- c. Teknikën me të cilin realizojnë veprën.

Modeli i propozuar (figurë njeriu) para kandidatëve, shërben si shkak që ata, në mënyrë të ndërgjegjshme të ekspozojnë më qartë një qëndrim individual të shprehjes artistike. Duke mos kushtëzuar prerjen e figurës sipas nje kompozimi standart, si dhe teknikën me të cilën do të realizohet vepra, studenti t i jepet mundesia të interpretojë nga pikëpamja kompozicionale, si edhe në drejtim të hulumtimit psikologjik, të zgjedhë mjetin dhe format e shprehjes nëpërmjet një raporti ndjesor më personal me figurën e propozuar.

Baza Materiale

Kandidatët për Studentë duhet të vijnë të përgatitur me këto materiale përkatëse:

Letër Vizatimi 70x90, (të bardhë)

Telajo Pikturë 70x90, si dhe të gjitha mjetet e tjera plotësuese për të realizuar një vepër në vizatim apo në telajo(pikturë).

2. Testimi Teorik, i cili në vetevete përmban tre faza të përshkruara si më poshtë:

Kohëzgjatja: 2 ditë + (në varësi të nr. të konkurentëve)

Faza e parë është testimi teorik i kandidatit për student në Lëndën Histori Arti, nëpërmjet përgjigjes direkte mbi tezën e zgjedhur. Teza është e fshehte.

Literatura së ciles do t'i referohet cdo kandidat per tu përgatitur:

- Të gjithë tekstet teorike apo materialet me të cilat kanë studiuar nxenesit në shkollat e mesme artistike apo të përgjithshme.
- Historia e Artit (E.H. Gombrich)
- Aventurë e Artit në shek.XX dhe materiale të tjera alternative.

Faza e Dytë është intervista e kandidatit për student me anëtarët e Komisionit.



Qëllimi është testimi i nivelit të përgjithshëm kulturor, ndjeshmëritë artistike, marrëdhënien e tij me një proces artistik që ai kryen, kërkesat e tij, si dhe ato cka ky fakultet kërkon prej.

Faza e Tretë është **shqyrtimi i Dosjes Personale** të kandidatit për student, në të cilën ai prezanton një grup punësh të realizuara kryesisht gjatë dy viteve të fundit. Këto punë mund dhe duhet të plotësojnë imazhin e punës praktike që ai kryen në atelie në dy ditët e para të konkursit.

Dosja profesionale personale do të duhet të përmbajë vizatime e skica të ndryshme, realizime me laps karbon etj., si edhe realizime në vaj, tempera, akuarel etj. Numri i përgjithshëm i punimeve që duhet të përmbajë dosja të jetë jo më pak se 20.

Shënim:

Kandidati për student është përgjegjës për autorësinë e materialit që prezanton në dosjen e tij personale. N.q.s nga Komisioni verifikohet material i manipuluar, pra jo produkt i kandidatit, ndaj tij do të merret masa e largimit nga procesi i konkursit për këtë vit akademik.

Përgjegjësi i Departamentit të Pikturës

Prof. Asc. Edmond Gjikopulli



Nr. _____prot.

Tiranë, më _____ 2018

Drejtuar : Dekanit te FAB, Prof.Asc, Ardian Isufi

Lenda:

KRITERET TEKNIKE SI DHE RUBRIKAT E KONKURSIT TË PRANIMIT NË

CIKLIN I-BACHELOR-FAKULTETIN E ARTEVE TE BUKURA

PROGRAMI I STUDIMIT QERAMIKE

VITI AKADEMIK 2019-2020

Konkursi për seleksionim dhe përzgjedhjen e kandidatëve të rinj do të zhvillohet sipas kriterëve teknike të përcaktuara si më poshtë:

Konkursi do të mbështetet në tre rubrika kryesore për të arritur nivelin më të mirë të mundshëm të testimit të një kandidati brenda kohës së caktuar:

Rubrikat:

1. Punë Praktike në Atelie (skulpture, vizatim)

2. Testim teorik

3. Prezantim i dosjes personale (orientimi skulpture qeramike)

1. Punë Praktike në Atelie do të zhvillohet si më poshtë:

Kohëzgjatja : 2 ditë nga 5 orë

Tema e veprës: Studim dhe interpretim nga natyra duke ju referuar figurës së njeriut (model nga natyra)

Dimensioni i veprës: formati 70 x 90 cm

Teknika e përdorur: Vizatim ose Skulpture



Disa sqarime të mëtejshme të kriterëve të mësipërme.

Studimi nga Natyra do të propozohet dhe organizohet si më poshtë:

Në të gjitha atelietë e shkollës ku do të zhvillohet testimi praktik i kandidatëve për studentë do të ketë modele të vendosur (figurë njeriu).

Studentët do të prezantohen me modelet dhe më pas ata do të vendosin:

- a. Cilin model zgjedhin.
- b. Mënyren se si kompozojnë.
- c. Teknikën me të cilin realizojnë veprën.

Modeli i propozuar (figurë njeriu) para kandidateve, shërben si shkak që ata, në mënyrë të ndërgjegjshme të ekspozojnë më qartë një qëndrim individual të shprehjes. Duke mos kushtezuar prerjen e Figurës sipas nje kompozimi Standart, si dhe teknikën me të cilën do të realizohet vepra, studentit vihet në pozicion krijues, ku i jepet mundësia të interpretojë si nga pikepamja kompozicionale po ashtu edhe ne drejtim të hulumtimit psikologjik, të zgjedhë mjetin dhe format e shprehjes nëpërmjet një raporti ndjesor më personal me figurën e propozuar.

Baza Materiale

Kandidatët për Studentë duhet të vijnë te përgatitur me këto materiale përkatëse:

Letër Vizatimi formati 70x90, (të bardhë)

2. Testimi Teorik i cili ne vetevete permban tre faza të përshkruara si më poshte

Kohezgjatja: 2 dite + (në varësi të nr. të konkurentëve)

Fazat:

Faza e parë është Testimi i Kandidatit per Student ne Lenden Histori Arti. Ky testim do te kryhet nepermjet pergjigjes direkte mbi Tezen e Zgjedhur. Teza eshte e fshehte.

Literaturë së ciles do t'i referohet cdo kandidat per tu pergatitur:

- Të gjithë tekstet teorike apo materialet me të cilat kanë studiuar nxenesit në shkollat e mesme artistike apo te pergjithshme
- Historia e Artit (E.H. Gombrich)



- Aventurë e Artit në shek.XX dhe materiale të tjera alternative.

Faza e Dytë është Interviste e Kandidatit për Student me Anëtarët e Komisionit.

Qëllimi është: Për të testuar nivelin e përgjithshëm kulturor, ndjeshmëritë artistike, marrëdhënien e tij me një proces artistik që ai kryen, e lidhur kjo ngushte me formacionin e fakultetit, kërkesat tij si dhe ato cka ky fakultet kërkon prej studenteve dhe i ofron atyre njekohesisht.

Faza e Tretë është shqyrtimi i Dosjes Personale të Kandidatit për Student, në të cilën ai prezanton praktikisht një grup punesh të kryera prej tij kryesisht gjate dy viteve të fundit, dhe që ai mendon se bëjnë prezantimin më të mirë artistik të tij. Këto punë mund dhe duhet të plotësojnë imazhin e punës praktike që ai kryen në atelie në dy ditët e para të konkursit.

Dosje profesionale personale duhet të përmbajë:

Vizatime e skica të ndryshme, realizime me laps karbon, realizime në skulpture dhe qeramike, foto të punimeve. etj.

Numri i përgjithshëm i punimeve që duhet të përmbajë dosja të jetë jo më pak se 20.

Shënim: Kandidati për student është përgjegjës për autorësinë e materialit që prezanton në dosjen e tij personale. N.q.s nga Komisioni verifikohet material i manipuluar, pra jo produkt i kandidatit, ndaj tij do të merret masa e largimit nga procesi i konkursit për këtë vit akademik.

Përgjegjesi i Dep, te Arteve te Aplikuara

Prof. Asc. Pjerin Kolnikaj



Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ 2018

Drejtuar : Dekanit te FAB, Prof.Asc, Ardian Isufi

Lenda:

KRITERET TEKNIKE SI DHE RUBRIKAT E KONKURSIT TË PRANIMIT NË

CIKLIN I-BACHELOR-FAKULTETIN E ARTEVE TE BUKURA

PROGRAMI I STUDIMIT SKULPTURE

VITI AKADEMIK 2019-2020

Konkursi për seleksionim dhe përzgjedhjen e kandidatëve të rinj do të zhvillohet sipas kriterëve teknike të përcaktuara si më poshtë:

Konkursi do të mbështetet në tre rubrika kryesore për të arritur nivelin më të mirë të mundshëm të testimit të një kandidati brenda kohës së caktuar:

Rubrikat:

- 1. Punë Praktike në Atelie (skulpture, vizatim)**
- 2. Testim teorik**
- 3. Prezantim i dosjes personale (orientimi skulpture)**

1. Punë Praktike në Atelie do të zhvillohet si më poshtë:

Kohëzgjatja : 2 ditë nga 5 orë

Tema e veprës: Studim dhe interpretim nga natyra duke ju referuar figurës së njeriut (model nga natyra)

Dimensioni i veprës: formati 70 x 90 cm

Teknika e përdorur: Vizatim ose Skulpture



Disa sqarime të mëtejshme të kriterëve të mësipërme.

Studimi nga Natyra do të propozohet dhe organizohet si më poshtë:

Në të gjitha atelietë e shkollës ku do të zhvillohet testimi praktik i kandidatëve për studentë do të ketë modele të vendosur (figurë njeriu).

Studentët do të prezantohen me modelet dhe më pas ata do të vendosin:

- a. Cilin model zgjedhin.
- b. Mënyren se si kompozojnë.
- c. Teknikën me të cilin realizojnë veprën.

Modeli i propozuar (figurë njeriu) para kandidateve, shërben si shkak që ata, në mënyrë të ndërgjegjshme të ekspozojnë më qartë një qëndrim individual të shprehjes. Duke mos kushtezuar prerjen e Figurës sipas nje kompozimi Standart, si dhe teknikën me të cilën do të realizohet vepra, studenti vihet në pozicion krijues, ku l jepet mundësia të interpretoje si nga pikepamja kompozicionale po ashtu edhe ne drejtim të hulumtimit psikologjik, të zgjedhë mjetin dhe format e shprehjes nëpërmjet një raporti ndjesor më personal me figurën e propozuar.

Baza Materiale

Kandidatët për Studentë duhet të vijnë te përgatitur me këto materiale përkatëse:

Letër Vizatimi formati 70x90, (të bardhë)

2. Testimi Teorik i cili ne vetevete permban tre faza të përshkruara si më poshte

Kohezgjatja: 2 dite + (në varësi të nr. të konkurentëve)

Fazat:

Faza e parë është Testimi i Kandidatit per Student ne Lenden Histori Arti. Ky testim do te kryhet nepermjet pergjigjes direkte mbi Tezen e Zgjedhur. Teza eshte e fshehte.

Literaturë së ciles do t'i referohet cdo kandidat per tu pergatitur:

- Të gjithë tekstet teorike apo materialet me të cilat kanë studiuar nxenesit në shkollat e mesme artistike apo te pergjithshme
- Historia e Artit (E.H. Gombrich)



Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 247 597, www.uart.edu.al
- Aventurë e Artit në shek.XX dhe materiale të tjera alternative.

Faza e Dytë është Interviste e Kandidatit për Student me Anëtarët e Komisionit.

Qëllimi është: Për të testuar nivelin e përgjithshëm kulturor, ndjeshmëritë artistike, marrëdhënien e tij me një proces artistik që ai kryen, e lidhur kjo ngushte me formacionin e fakultetit, kërkesat tij si dhe ato cka ky fakultet kërkon prej studenteve dhe i ofron atyre njekohesisht.

Faza e Tretë është shqyrtimi i Dosjes Personale të Kandidatit për Student, në të cilën ai prezanton praktikisht një grup punesh të kryera prej tij kryesisht gjate dy viteve të fundit, dhe që ai mendon se bëjnë prezantimin më të mirë artistik të tij. Këto punë mund dhe duhet të plotësojnë imazhin e punës praktike që ai kryen në atelie në dy ditët e para të konkursit.

Dosje profesionale personale duhet të përmbajë:

Vizatime e skica të ndryshme, realizime me laps karbon, realizime në skulpturë, foto të punimeve.
etj.

Numri i përgjithshëm i punimeve që duhet të përmbajë dosja të jetë jo më pak se 20.

Shënim: Kandidati për student është përgjegjës për autorësinë e materialit që prezanton në dosjen e tij personale. N.q.s nga Komisioni verifikohet material i manipuluar, pra jo produkt i kandidatit, ndaj tij do të merret masa e largimit nga procesi i konkursit për këtë vit akademik.

Përgjegjesi i Dep, te Arteve te Aplikuara

Prof. Asc. Pjerin Kolnikaj
